



# RAPORT PËRMBLEDHËS I AKTIVITETEVE TË PLATFORMËS CIVIKOS PËR VITIN 2016

---

Prishtinë 2016

Sekretariati i Platformës CiviKos gjatë vitit 2016 është mbështetur financiarisht nga:

- Komisioni Evropian –Zyra e BE-së në Kosovë
- Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).
- TACSO - Zyra në Kosovë

#### LISTA E AKRONIMEVE

|                              |                                                                                                                                           |
|------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>CiviKos</b>               | Platforma CiviKos                                                                                                                         |
| <b>CNVOS</b>                 | Qendra për shërbime informuese, bashkëpunim dhe zhvillim të OJQ-ve (Centre for Information Service, Co-operation and Development of NGOs) |
| <b>OSHC</b>                  | Organizatë e Shoqërisë Civile                                                                                                             |
| <b>OSBE</b>                  | Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë                                                                                           |
| <b>KCSF</b>                  | Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile                                                                                                     |
| <b>KFOS</b>                  | Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur                                                                                                   |
| <b>GIZ</b>                   | Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit                                                                                            |
| <b>ZQM/KM</b>                | Zyra për Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit                                                                                   |
| <b>ZKM</b>                   | Zyra e Kryeministrit                                                                                                                      |
| <b>Strategjia Qeveritare</b> | Strategjia Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017                                                                       |
| <b>Strategjia e CiviKos</b>  | Strategjia e Platformës CiviKos 2015-2017                                                                                                 |
| <b>Këshilli</b>              | Këshilli për zbatimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile                                                        |

## **PËRMBAJTJA:**

|                                                                          |           |
|--------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>FJALA E DREJTORESHËS EKZEKUTIVE TË PLATFORMËS CIVIKOS.....</b>        | <b>4</b>  |
| <b>HYRJA.....</b>                                                        | <b>5</b>  |
| <b>INFORMATA DHE FAKTE TË SHKURTËRA RRETH CIVIKOS-it GJATË 2016.....</b> | <b>6</b>  |
| <b>BASHKËPUNIMI SHOQËRI CIVILE- QEVERI.....</b>                          | <b>7</b>  |
| <b>BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATA ANËTARE.....</b>                           | <b>8</b>  |
| <b>AKTIVITETET E SEKRETARIATIT TË CIVIKOS.....</b>                       | <b>11</b> |
| <b>KONSULTIMI PUBLIK ME ORGANIZATA ANËTARE TË CIVIKOS.....</b>           | <b>12</b> |
| <b>PROGRAMI I PRAKTIKANTËVE NË PLATFORMËN CIVIKOS.....</b>               | <b>14</b> |
| <b>CIVIKOS NË MEDIA.....</b>                                             | <b>15</b> |
| <b>ZBATIMI I KODIT ETIK TË PLATFORMËS CIVIKOS PËR VITIN 2015.....</b>    | <b>16</b> |

Të nderuar miq e kolegë,

Viti që e lamë pas, nuk ishte vit i lehtë për vendin tonë pasi që është përcjellë me një varg shqetësimesh, pakënaqësive dhe një varg protestash për demarkacionin me Malin e Zi, për humbjen e jetës në burg të aktivistit politik Astrit Deharit duke kërkuar drejtësi, qoftë për trajtim jo të dinjitetshëm të pacienteve e grave në veçanti, qasja në drejtësi e grave dhe shumë çështje tjera që kanë ndikuar gjithsesi në jetën e qytetarëve po edhe në punën tonë si aktivistë dhe si organizata të shoqërisë civile.

Përkundër gjithë këtyre sfidave që na kanë përcjellë si shoqëri, megjithatë kemi arritë që të kemi disa rezultate konkrete duke finalizuar rregulloren e re - Rregullorja për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik, si dhe dizajnohet Platforma online e cila do të jetë mjeti kryesor i organizimit të konsultimit publik nga ana e Qeverisë, pas një procesi gjithëpërfshirës dhe pune të përbashkët të organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve publike.

Një hap tjetër poashtu i rëndësishëm është edhe puna intensive që është bërë deri në përcaktimin e modelit për financim publik për OSHC-të, që për Kosovë do të jetë model i decentralizuar i financimit publik për OSHC-të, e në mënyrë paralele është punuar në hartimin e Rregullores mbi procedurat për Shpërndarjen e Fondeve Publike, e cila pritet të finalizohet në vitin e ardhshëm.

Vullnetarizmi si një komponentë jashtëzakonisht e rëndësishme jo vetëm për shoqërinë tonë, por besoj për çdo shoqëri tjetër, por që ende nuk është rregulluar me korniza ligjore, ani pse sa i përket të rinjëve është e rregulluar në kuadër të Ligjit për fuqizimin e rinisë, por që nuk është e mjaftueshme dhe do të duhej të rregullohej qartë në mënyrë që të kontribuojë në zhvillim të gjithëmbarshtëm të shoqërisë dhe vendit.

Konsultimet dhe vizitat tek organizatat anëtare jo vetëm që na kanë mbajtur azhur në punën tonë, por edhe me idetë konkrete, shembujt e shumtë pozitiv e kanë pasuruar edhe punën në Këshill, në ekipet e punës së Këshillit dhe në aktivitetet e CiviKos-it në përgjithësi, andaj konsultimet dhe vizitat tek ju miq dhe anëtarë do të jenë një prej praktikave që do t'i bartim edhe në vitet që vijnë.

Së fundmi, duke e parë një punë të madhe që është bërë në Këshill, po në anën tjetër ende kishim ngecje dhe problematika nga ana e Institucioneve, ne bashkërisht me Bordin dhe anëtarët vendosëm që në vend të Kuvendit të Anëtarëve gjatë vitit 2016, të organizojmë konferencën vjetore, ku e patëm mysafirë Kryeministrin e Republikës së Kosovës z. Isa Mustafa, më të cilin bashkëbiseduam hapur në lidhje më të gjitha sfidat, shqetësimet dhe pengesat që ne si organizata i kemi, ku një numër i madh i organizatave shfrytëzuan hapësirën e dhënë për t'i adresuar çështjet më rëndësi sa i përket bashkëpunimit qeveri-shoqëri civile.

Dhe për fund, dua të nënvizoj se pa anëtarët e Platformën CiviKos, Bordin si dhe donatorët dhe partnerët, nuk do të arrinim rezultate. Shumë falenderuese për bashkëpunim dhe përkrahje nga të gjithë. Na presin sfidat e radhës por jam e sigurtë që duke bashkëpunuar, duke reflektuar dhe duke qenë edhe vet kritik do t'ia dalim.

Valdete Idrizi  
Drejtoreshë ekzekutive



## **HYRJE**

### **PLATFORMA CIVIKOS**

Platforma CiviKos është bashkim vullnetar i organizatave të shoqërisë civile, të përkushtuara për zhvillimin e një mjedisi të favorshëm për bashkëpunim midis shoqërisë civile dhe autoriteteve publike. Që nga themelimi i saj Platforma CiviKos ka qenë e angazhuar që të jetë zë i organizatave të shoqërisë civile në Kosovë, duke krijuar një ambienti sa më të favorshëm të bashkëpunimit shoqëri civile-qeveri.

### **STRATEGJIA E PLATFORMËS CIVIKOS**

**Platforma CiviKos në periudhën 2015-2017 do të fokusohet në këto objektiva strategjike:**

- Fuqizimin e marrëdhënieve me organizatat anëtare dhe jo-anëtare përmes Qendrave Rajonale të CiviKos,
- Portfolio e zgjeruar e shpërndarjes së informatave dhe shërbimeve tjera me interes për OSHC-të.
- Koordinimin e shoqërisë civile për zbatimin e Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile, dhe
- Zhvillimi i dialogut të strukturuar mes shoqërisë civile dhe autoriteteve tjera publike.

## **CIVIKOS GJATË 2016- INFORMATA DHE FAKTE TË SHKURTËRA**

- 190 organizata anëtare në CiviKos.
- Bordi i Platformës CiviKos gjatë vitit 2016 ka mbajtur 6 takime të rregullta dhe shumë takime jo formale.
- Janë shpërndarë rreth 126 dokumente qeveritare për konsultim publik, buletine të rregullta të aktiviteteve të CiviKos si dhe informata relevante për shoqërinë civile.
- Gjatë vitit 2016 Sekretariati i CiviKos ka publikuar dy raporte të monitorimit: Konsultimi publik me organizata anëtare për vitin 2015, si dhe Raporti i Monitorimit për Zbatimin e Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017.
- CiviKos përfundon vlerësimin rreth zbatimit të Kodit Etik të Platformës CiviKos nga organizatat anëtare, i cili raport do të publikohet në Kuvendin e Anëtarëve të CiviKos, për vitin 2016.
- CiviKos organizon takim informues me Rrjetin Ballkanik Zhvillimor për shoqëri civile BCSDN rreth iniciativës globale për llogaridhënien tek organizatat.
- Gjatë vitit 2016 së bashku me 5 Qendrat Rajonale, Sekretariati i CiviKos ka organizuar dy raunde të takimeve konsultative me organizata të shoqërisë civile, një në Maj- Qershor, si dhe një seri të takimeve informuese në muajin Nëntor-Dhjetor 2016.
- Në Nëntor 2016 CiviKos organizoi takim me Kryeministrin e Republikës së Kosovës me organizata të shoqërisë civile ku u adresuan sfidat në procesin e bashkëpunimit shoqëri civile-Qeveri. Përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile shfrytëzuan hapësirën për adresimin e qështjeve me rëndësi tek Kryeministri.
- CiviKos gjatë vitit 2016 ka vazhduar të përkrahë organizatat anëtare, duke iu ofruar shërbime rreth shpërndarjes së informatave, ofrimin e hapësirës së vet, dhe duke ndihmuar në vendosje të kontaktit mes OSHC-ve.

## BASHKËPUNIMI SHOQËRI CIVILE- QEVERI

### *Zbatimi i Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013-2017*

Sekretariati i Platformës CiviKos përveç koordinimit të aktiviteteve për zbatim të Strategjisë Qeveritare, ka monitoruar në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e Strategjisë Qeveritare, si dhe ka lehtësuar pjesëmarrjen e anëtarëve të shoqërisë civile në tërë procesin. Të dhënat nga matrica e monitorimit janë shfrytëzuar nga anëtarët e shoqërisë civile në Këshill për të krijuar një pasqyrë më të qartë të zbatimit të Strategjisë Qeveritare.

Gjatë vitit 2016 Këshilli për Zbatimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile ka mbajtur 3 takime të rregullta. Grupet e punës të Këshillit kanë mbajtur takime në mënyrë të vazhdueshme, duke kontribuar në zbatim të aktiviteteve të objektivave strategjike.

Një raport përmbledhës më të detajuar rreth zbatimit të Strategjisë deri më tani përgatitur nga Sekretariati i CiviKos i cili është publikuar në Nëntor 2016 mund ta gjeni në linkun më poshtë:

[http://civikos.net/repository/docs/RAPORTI\\_STRATEGJSIE\\_CIVIKOS\\_Final\\_157266.pdf](http://civikos.net/repository/docs/RAPORTI_STRATEGJSIE_CIVIKOS_Final_157266.pdf)

### **Disa nga të arriturat dhe sfidat kryesore në zbatim të Strategjisë Qeveritare:**

| <b>Të arriturat kryesore të Strategjisë</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         | <b>Sfidat në zbatim të Strategjisë Qeveritare</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <ul style="list-style-type: none"> <li>• Miratohet Rregullorja për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik, si dhe dizajnohet Platforma online e cila do të jetë mjeti kryesor i organizimit të konsultimit publik nga ana e Qeverisë.</li> <li>• Certifikata e OJQ-ve bëhet dokument i pranueshëm në procesin e prokurimit publik.</li> <li>• Përcaktohet modeli i decentralizuar i financimit publik për OSHC-të, ku dhe është në përfundim hartimi i Rregullores mbi Standardet Minimale, dhe Procedurat për Shpërndarjen e Fondeve Publike.</li> <li>• Janë vendosur bazat e modelit për kontraktim të shërbimeve publike për OSHC.</li> <li>• Janë duke u zhvilluar hulumtime dhe analiza në fushën e vullnetarizmit.</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vonesa fillestare në konsolidimin e Këshillit dhe fillimin e zbatimit të Strategjisë Qeveritare.</li> <li>• Mos ndarja e buxhetit nga ana e Qeverisë për zbatim të Strategjisë.</li> <li>• Mos angazhimi i anëtarëve të Këshillit nga ana e Qeverisë në Këshill.</li> <li>• Kapacitetet e limiturata të Zyrës për Qeverisje të Mirë (ZQM) në koordinim të zbatimit të Strategjisë Qeveritare.</li> <li>• Mungesë e një sistemi të mirëfillt të monitorimit të zbatimit të Strategjisë Qeveritare nga ana e ZQM.</li> </ul> |

## **BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATA ANËTARE**

### **CiviKos organizon takime konsultative me organizata të shoqërisë civile nëpër Komuna**

Sekretariati i Platformës CiviKos ka bashkëpunuar në mënyrë të vazhdueshme me 5 Qendrat Rajonale të CiviKos, duke shtrirë dhe promovuar praktikën e bashkëpunimit mes shoqërisë civile dhe autoriteteve publike edhe në nivelin lokal. Përveq informatave të shpërndara përmes Qendrave Rajonale, CiviKos gjatë 2016 ka organizuar dy runde të takimeve konsultative me organizata të shoqërisë civile nga gjithë Kosova.



#### **Takime informuese me organizata të shoqërisë civile Raundi I-rë (Maj 2016)**

Gjatë muajit Maj 2016, Sekretariati i CiviKos së bashku me organizatat partnere që shërbejnë si Qendra Rajonale të CiviKos ka mbajtur 5 takime konsultative me organizata anëtare në 5 Qendra të Kosovës Mitrovicë, Gjiilan, Pejë, Ferizaj dhe Prizren.



#### **Takime informuese me organizata të shoqërisë civile Raundi II-të (Nëntor-Dhjetor 2016)**

Gjatë muajit Nëntor- Dhjetor 2016 me mbështetje të TACSO zyra në Kosovë Sekretariati i CiviKos organizon takime informuese me organizata të shoqërisë civile në 5 qendra të Kosovës Mitrovicë, Gjiilan, Pejë, Ferizaj dhe Prizren, duke i informuar për së afërmi rreth zbatimit të Strategjisë Qeveritare.





## **ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE NË KOSOVË PJESË E KONSULTIMEVE RRETH NISMËS GLOBALE “Standardet e Llogaridhënies dhe Transparencës për organizata të shoqërisë civile”**

Sekretariati i Platformës CiviKos së bashku me Rrjetin Zhvillimor Ballkanik për shoqëri civile BCSDN në Tetor 2016 organizon takim me organizata të shoqërisë civile në Kosovë, për të diskutuar rreth nismës globale për promovimin e standardeve të llogaridhënies dhe transparencës për organizata të shoqërisë civile. Përfaqësuesit e BCSDN prezantuan parimet kryesore të këtyre standardeve.

Pjesëmarrësit prezantuan disa nga iniciativat që ekzistojnë në Kosovë rreth llogaridhënies dhe transparencës brenda sektorit të shoqërisë civile ku pjesë është edhe Kodi Etik i Platformës CiviKos.



## **CIVIKOS ORGANIZON TAKIM ME KRYEMINISTRIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS ISA MUSTAFA**


Me datë 21 Nëntor 2016 në ambientet e Sheshi 21 Sekretariati i CiviKos organizoi takim në mes të organizatave të shoqërisë civile dhe Kryeministrit të Republikës së Kosovës Isa Mustafa. Qëllimi i këtij bashkëbisedimi me Kryeministrin ishte adresimi i sfidave rreth bashkëpunimit shoqëri civile-qeveri në përgjithësi. Përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile në përgjithësi adresuan qështje me rëndësi për sektorin tek Kryeministri. Pas

këtij takimi Kryeministri morri pjesë edhe në takimin e rregullt të Këshillit për zbatim të Strategjisë Qeveritare.



## **CIVIKOS PJESE E SHËNIMIT TË DITËS NDËRKOMBËTARE TË DEMOKRACISË**

Me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Demokracisë, Kuvendi i Kosovës me ndihmën e Sekretariatit të Platformës CiviKos organizoi panairin e shoqërisë civile me datë 15 Shtator 2016, para Kuvendit të Kosovës. Në panair morën pjesë një numër i organizatave ku ekspozuan materialet promovuese të tyre, duke qenë pjesë e aktiviteteve të shumta të organizuar nga Kuvendi i Kosovës. Po ashtu Sekretariati i CiviKos ka prezantuar publikime dhe raporte të ndryshme në këtë panair.



## **TAKIM MES ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE DHE DEPARTAMENTIT PËR OJQ**

Sekretariati i CiviKos së bashku me përfaqësues të Departamentit për Regjistrim të OJQ-ve në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike në Shkurt 2016 organizuan takim informues me organizata të shoqërisë civile rreth iniciativës së departamentit për krijimin e regjistrimit elektronik të regjistrimit të OJQ-ve. Përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile bashkëbiseduan me zyrtar të

departamentit edhe për obligimet e organizatave ndaj departamentit.

## AKTIVITETET E SEKRETARIATIT TË CIVIKOS

Edhe gjatë vitit 2016 Sekretariati i Platformës CiviKos ka qenë aktiv duke marrë pjesë në aktivitetet e



**Valdete Idrizi në panel: Stereotipet Gjinore, organizuar nga OSBE Kosovë.**

organizatave anëtare, duke i promovuar dhe mbështetur këto aktivitete. Po ashtu CiviKos në mënyrë të vazhdueshme ka organizuar takime me përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, studentë të Universitetit të Londrës, dhe Majamit nga Amerika, duke ndarë praktikatat e bashkëpunimit mes shoqërisë civile dhe autoriteteve publike. Gjatë vitit 2016 Sekretariati i CiviKos ka qenë aktiv edhe në konferenca ndërkombëtare duke promovuar bashkëpunimin mes shoqërisë civile dhe qeverisë.

## SHËRBIMI INFORMUES I CIVIKOS NDAJ ORGANIZATAVE ANËTARE

Përveç koordinimit në bashkëpunimin shoqëri civile - qeveri, Sekretariati i CiviKos-it në mënyrë të vazhdueshme ka shpërndarë informata të ndryshme për anëtarë, të cilat informata janë të ndërlidhura me bashkëpunimin shoqëri civile – institucione. Po ashtu ka shpërndarë informata në fusha tjera që janë relevante për shoqërinë civile si: mundësi për grante, mundësi pjesëmarrjeje në konferenca të ndryshme, vizita studimore, programe edukative, trajnime të ndryshme etj. Gjatë vitit 2016 janë dërguar rreth 125 njoftime të cekura përmes emailit dhe e-newsletter. Ueb faqja e CiviKos [www.civikos.net](http://www.civikos.net) është dhe një mundësi më shumë për të publikuar raporte apo informata tjera me rëndësi për sektorin. Gjithashtu të gjithë abonuesit pranojnë informata nga e-newsletter, shërbim ky që ofrohet në këtë faqe. Aktualisht më shumë se 350 e-mail adresa janë të regjistruara në këtë sistem.

CiviKos në mënyrë të vazhdueshme promovon ngjarjet dhe aktivitetet e ndryshme të organizatave anëtare duke shfrytëzuar shërbimin informues, web faqën e CiviKos dhe rrjetet sociale.

## KONSULTIMI PUBLIK ME ORGANIZATA ANËTARE TË CIVIKOS

### Disa të gjetura nga raporti i monitorimit për vitin 2016

Sekretariati i Platformës CiviKos përveç shpërndarjes së dokumenteve qeveritare për konsultim publik me organizatat anëtare, ka monitoruar në mënyrë të vazhdueshme procesin e konsultimit publik që Qeveria e Kosovës organizon me shoqëri civile. Një raport më i detajuar do të publikohet së shpejti.

#### Të gjeturat kryesore:

- Gjatë vitit 2016 gjithsej 137 dokumente qeveritare janë dërguar për konsultim publik tek Sekretariati i Platformës CiviKos.
- Nga 137 dokumente qeveritare të shpërndara për konsultim publik gjatë vitit 2016, 34 kanë qenë Projektligje, 51 Udhëzime Administrative, 24 Projekt-Rregullore, 15 Koncept Dokumente, 10 Strategji, 2 Ligje, 1 dokument tjetër.
- Në Agjendën Legjislative të Qeverisë së Kosovës kanë qenë të parapara për plotësim ndryshim gjithsej 112 projektligje, ndërsa Qeveria e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2016 ka miratuar vetëm 53 projekt-ligje.
- Nga 53 projektligje të miratuara vetëm 29 prej tyre janë dërguar për konsultim publik tek Sekretariati i Platformës CiviKos.
- Nga gjithsej 41 Dokumente Strategjike të planifikuara për hartim në vitin 2016, 8 prej tyre janë miratuar në Qeveri ndërsa vetëm 2 prej këtyre dokumenteve strategjike janë dërguar për konsultim publik tek Sekretariati i Platformës CiviKos.



## ORGANIZATAT ANËTARE FLASIN PËR BASHKËPUNIMIN E TYRE ME CIVIKOS

### Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë – QKSS

“QKSS - përfiton nga informatat e dërguara nga Platforma CiviKos për kontribut për ndryshimin dhe plotësimin e draft ligjeve të ndryshme.

- QKSS përmes Platformës CiviKos ka shpërndarë thirrje për aplikim dhe ftesa për aktivitete të ndryshme, ku si rezultat i shpërndarjes nga Platforma, efekti i shpërndarjes së informatave ka qenë shumë i madh dhe pozitiv.
- QKSS ka aplikuar në grante të cilat janë dërguar si informata nga Platforma CiviKos.”

### Shoqata e Grave të Policisë së Kosovës

“Ndër bashkëpunimet e para që Shoqata e Grave të Policisë së Kosovës ka krijuar me organizatat vendore në Kosovë, është vet Platforma Civikos. ShGPK është anëtarësuar në këtë organizatë që shërben si rrjet i OJQ-ve në Kosovë. Bashkëpunimi i jonë me Platformën CiviKos është i shkëlqyer! Platforma CiviKos ka shpërndarë informacione për trajnime dhe konferenca të ndryshme në vend dhe jashtë vendit, ku një numër i anëtarëve të Shoqatës së Grave të Policisë së Kosovës ka qenë pjesë në këto aktivitete. ShGPK numëron mbi 740 anëtarë dhe është e hapur edhe në të ardhmen për bashkëpunim në aktivitete të cilat ngrisin imazhin e gruas në Policinë e Kosovës dhe kontribuojnë në avancimin e tyre profesional”



## PROGRAMI I PRAKTIKANTËVE NË PLATFORMËN CIVIKOS

### Leonita Gojani

“Përvoja ime në Platformën CiviKos, ka qenë kontakti i parë në një ambient dhe punë më profesionale. Javët e para ishin orët e ambientimit, ku u njoftova me stafin e mrekullueshëm, të cilët më ndihmonin të hyja në rrjedhat e punës.

Praktika ime ishte kryesisht e fokusuar në fushën e hulumtimit, në analizimin e të dhënave të hulumtuara dhe pasqyrimin e tyre në programin SPSS. Mirëpo, në kohën kur nuk kisha angazhim në hulumtim, isha në gadishmëri që të ndihmoj stafin në punë të tjera të zyrës, qoftë në përditësimin e web-faqes së CiviKos-it, apo në punët administrative dhe financiare. Në ditë të caktuara të javës, kam marrë pjesë në konferenca me tema të ndryshme, kryesisht të fokusuara në rininë, shoqërinë civile dhe sfidat me të cilat përballet Kosova në fusha të ndryshme.

Gjatë 2 muajve sa isha praktikante në CiviKos, isha në kontakt me organizata të ndryshme, për të caktuar takime në të cilat do të zhvillonim intervistat përkatëse të organizatave, për programet e tyre në angazhimin e praktikantëve. Kjo përvojë më ndihmoi shumë që të njihem me programet e organizatave të ndryshme, të mësoj mbi punën e tyre, dhe ndoshta mundësitë që në të ardhmen të jem pjesë e ndonjë organizate e cila përshtat me profilin tim të studimeve dhe interesave.

Periudha dy mujore e praktikës konsideroj se ishte kohë relativisht e shkurtër e praktikës, por gjatë së cilës kam mësuar shumë. Fusha e komunikimit, krijimi i kontakteve të reja, dhe puna fleksibile më kanë ndihmuar që të ngrihem profesionalisht, të jem e pregaditur për intervista ose punë në të ardhmen, duke përmirësuar aftësitë e mia njohëse dhe punuese.”

### Roland Sylejmani

“Përvoja ime në CiviKos ka qenë një prej përvojave më të mira që kam pasur si një i ri. CiviKos ka qenë mundësi e jashtëzakonshme për të njohur më mirë funksionimin e rrjetit të organizatave jo-qeveritare në Kosovë. Kjo përvojë ka tejkaluar parashikimet dhe pritjet e mia në lidhje me zhvillimin tim në sferën e aktivizmit në kuadër të aktiviteteve në shoqërinë civile. Angazhimi im përgjatë tre muajve në CiviKos ka qenë në shërbim të përfundimit të raportit me guximin individual, për t’i dhënë më shumë potencë zërit qytetar dhe asaj çka unë vendos të përfaqësojë.” Rolandi tani është duke punuar në organizatën Cultural Heritage without Borders – CHwB.

## CIVIKOS NË MEDIA

Platforma CiviKos ka qenë prezent në media të ndryshme për të promovuar aktivitetet për zbatimin e strategjisë qeveritare, punën e Këshillit, aktivitetet e Platformës CiviKos në raport me Këshillin, punën e qendrave rajonale të Platformës CiviKos, si dhe promovim i punës së organizatave anëtare të Platformës CiviKos. Duhet theksuar se mbulimi nga mediet këtë vit ka qenë dukshëm më i madh.

|                                                                                                                                                                                                                                              |                                                                                                                                                                                                                          |                                                                                                                                                                            |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|  <p><b>18 Korrik 2016</b><br/><b>Kryetarija Emini vlerëson punën e aktivistëve Idrizi (Epoka e Re)</b></p>                                                  |  <p><b>18 Korrik 2016</b><br/><b>Kryetarija e Komisionit për Integritet Evropian, Njomza Emini, takoi aktivistët Valdete Idrizi</b></p> |  <p><b>18 Korrik 2016</b><br/><b>Emini lavdëron punën e bërë nga Valdete Idrizi</b></p> |
|  <p><b>15 Korrik 2016</b><br/><b>Mysafiri i Mëngjesit- Zbatimi i Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë Civile, Dardan Kryeziu (RTK)</b></p> |  <p><b>14 Korrik 2016</b><br/><b>Kryetari Bahtiri ka uruar fituesen e çmimit ndërkombëtar për paqe, Valdete Idrizi</b></p>            |  <p><b>12 Korrik 2016</b><br/><b>Valdete Idrizi (KLAN Kosova)</b></p>                 |
|  <p><b>07 Korrik 2016</b><br/><b>Valdete Idrizi- Mysafire në BonBon (RTV21)</b></p>                                                                       |  <p><b>07 Korrik 2016</b><br/><b>Valdete Idrizi mori çmimin për paqe (RTK-Lajmet)</b></p>                                             |  <p><b>03 Korrik 2016</b><br/><b>Valdete Idrizi pranon çmimin për paqe (Zëri)</b></p> |



## ZBATIMI I KODIT ETIK TË PLATFORMËS CIVIKOS PËR VITIN 2015

---



## **Hyrje**

Kodit Etik i Platformës CiviKos i miratuar në Prill të vitit 2014 në Kuvendin e Anëtarëve të CiviKos është një iniciativë e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë për një vet-rregullim të sektorit i cili vepron mbi parime etike dhe profesionale dhe në mirëbesim reciprok. Sipas vendimit të Kuvendit të Anëtarëve, Kodi Etik nuk do të përmbajë dispozita dhe mekanizma sanksionues për një periudhë tre (3) vjeçare, pra deri në Kuvendin e 2017-ës, të identifikojmë vështirësitë e përmbushjes së obligimeve që dalin nga ky Kod, dhe bashkërendojmë përpjekjet e organizatave anëtare drejt përmbushjes së plotë të obligimeve që dalin nga ky Kod. Sekretariati i Platformës CiviKos në mënyrë të vazhdueshme ka bërë përpjekje për grumbullimin e të dhënave rreth zbatimit të Kodit Etik në mënyrë që me ndihmën e organizatave anëtare, që kanë ekspertizë në fusha të caktuara të ofrohen trajnime dhe mbështetje deri në zbatimin e plotë të këtij kodi.

## **Qëllimi i Kodit Etik**

Kodi Etik ka për qëllim të sigurojë bashkëpunim dhe raporte të ndërsjella në mes të anëtarëve të Platformës CiviKos të bazuara në parime etike dhe profesionale dhe në mirëbesim reciprok.

Kodi pasqyron përkushtimin e Platformës CiviKos dhe anëtarëve të saj ndaj parimeve etike në aktivitetet e tyre për të përmbushur misionin e Platformës. Respektimi, promovimi dhe zbatimi i Kodit nga të gjithë anëtarët është detyrim parimor dhe organizatat anëtare marrin për obligim që të ruajnë integritetin e këtij kodi.

## **Fushëveprimi**

Ky kod vlen në raportet ndërmjet organizatave anëtare të CiviKos-it, në raportet e organizatave anëtare me CiviKos-in dhe në raportet e organizatave anëtare me organizata jo-anëtare dhe palë të treta.

Kodi nuk vlenë në raportet e brendshme ndërmjet stafit të sekretariatit të CiviKos-it dhe në raportet e brendshme të cilat i takojnë qeverisjes së brendshme dhe autonomisë së organizatave anëtare.

Asgjë nga përmbajtja e Kodit nuk duhet kuptuar si ndërhyrje apo tendencë për ndërhyrje në autonominë dhe pavarësinë e organizatave anëtare në përcaktimin dhe zbatimin e politikave apo praktikave të caktuara të qeverisjes së brendshme të tyre, për aq sa ato politika apo praktika nuk bien ndesh me parimet udhëheqëse të CiviKos-it dhe ose të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të parapara me ligje vendore dhe ndërkombëtare.

## Parimet e Përgjithshme të Kodit

Kodi Etik i Platformës CiviKos ngërthen këto parime udhëheqëse të punës:

- Përgjegjësia dhe shërbimi publik,
- Bashkëpunimi efektiv,
- Të drejtat e njeriut dhe mundësitë e barabarta,
- Transparenca dhe Llogaridhënia,
- Vërtetësia dhe ligjshmëria.

Kodi Etik i Platformës CiviKos është vlerësuar si një nismë e mirëseardhur për të ngritë llogaridhënien e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë dhe për të promovuar vlerat e mirëfillta të demokracisë, dhe qeverisjes së brendshme të OSHC-ve në Kosovë .

## Rezultatet e hulumtimit rreth zbatimit të Kodit Etik të Platformës CiviKos për vitin 2015


Sekretariati i Platformës CiviKos për te lehtësuar grumbullimin e të dhënave rreth zbatimit të Kodit Etik të Platformës CiviKos nga organizatat anëtare të CiviKos ka përgatitur një pyetësor duke shfrytëzuar platformën google. Pyetësori është bazuar në parimet e Kodit Etik të Platformës CiviKos. Nga Muaji Korrik 2016 Sekretariati në mënyrë aktive është angazhuar në grumbullimin e informatave rreth zbatimit të Kodit Etik.

Po ashtu gjatë muajit Shtator Sekretariati ka realizuar edhe vizita nëpër regjione ku disa organizata janë kontaktuar drejtpërdrejt me qëllim grumbullimin e të dhënave të zbatimit të Kodit Etik.




1. Nga 181 organizata të Platformës CiviKos, 113 organizata i janë përgjigjur pyetësorit rreth implementimit të Kodit Etik, ndërsa 68 nuk janë përgjigjur në pyetësor.

## 2. Shtrija gjeografike e organizatave që janë përgjigjur në pyetësor




2. Sipas shtrirjes gjeografike të organizatave që kanë marr pjesë ne këtë hulumtim, 54 organizata janë nga komuna e Prishtinës, numër të njëjte të organizatave pjesëmarrëse respektivisht nga 11 organizata kishte Komuna e Prizrenit dhe Komuna e Gjilanit, 9 nga Komuna e Pejës, 5 nga Mitrovica Jugore, 3 organizata ishin nga Komuna e Ferizajit dhe Mitrovicës Veriore dhe nga vetëm 1 organizate nga komuna e Vitisë, Glogocit (Drenas), Fushë Kosovës, Kamenicës, Vushtrrisë dhe Podujevës.

### 3. Numri i stafit me pagesë




**3.** Nga 110 organizata që janë përgjigjur në pyetjen rreth numrit të stafit me pagesë, 31 organizata i takojnë grupit me 2-5 punëtorë, 18 organizata grupit 5-10 punëtorë, 21 organizata grupit me 11-20 punëtorë, 12 organizata grupit mbi 20 punëtorë, ndërsa 19 organizata kanë deklaruar se kanë zero punëtorë me pagesë dhe vetëm 4 organizata që varen nga donacionet.

**4. Sa ka qenë buxheti vjetor që organizata ka operuar gjatë vitit 2015?**



**4.** Sa i përket buxhetit vjetor që organizatat kanë operuar gjatë vitit 2015, 40 organizata i takojnë grupit me buxhet vjetor mbi 100.000 Euro, 18 organizata bëjnë pjesë ne grupin me buxhet vjetor prej 10.000-50.000 Euro, 18 organizata në grupin 50.000-100.000 Euro, 17 grupit me buxhet vjetor prej 0-10.000 Euro ndërsa 20 organizata kanë deklaruar se nuk kanë operuar fare me buxhet për vitin 2015.

**5. A keni pranuar fonde nga Qeveria e Kosovës gjatë vitit  
2014/2015?**




5. Nga 113 organizata, 73 organizata kanë deklaruar se nuk kanë pranuar fonde nga Qeveria e Kosovës gjatë vitit 2014/2015 ndërsa 40 organizata kanë deklaruar kanë pranuar fonde nga Qeveria e Kosovës.






**6.A keni përgatitur raporte financiare për vitin 2015?**




6.Sa i përket raportimit financiar për vitin 2015 nga numri total i organizatave 91 kane pohuar se kanë përgatitur raporte financiare për vitin 2015, ndërsa 22 organizata kanë deklaruar se nuk kanë përgatitur raporte financiare.

**6.1. (Nëse keni përgatitur raporte financiare), a i keni publikuar ato?**




6.1 Prej 101 organizatave që janë përgjigjur rreth publikimit të raporteve financiare 57 kanë pohuar se i kanë publikuar raportet financiare, dhe 44 që nuk i kanë publikuar.


### Arsyet pse organizatat nuk i kanë publikuar raportet financiare



6.2 Rreth arsyeve pse organizatat nuk i kanë publikuar raportet financiare, janë përgjigjur vetëm 42 organizata nga 57 sa kanë deklaruar se nuk i kanë publikuar raportet financiare. Nga 42 organizata sa janë përgjigjur, 19 organizata janë arsyetuar që nuk kanë webfaqe, 7 organizata kanë përgatitur raporte financiare vetëm për donatorët dhe autoritetet kompetente, 8 organizata kanë deklaruar se nuk e kanë obligim publikimin e raporteve financiare, 8 organizata nuk kanë pasur fonde.




6.3 Sa i përket publikimit të raporteve financiare dhe dëshmisë së publikimit, janë përgjigjur 48 organizata ku: 8 organizata e kanë dëshmuar me anë të webfaqes publikimin e raporteve financiare, 5 organizata kanë deklaruar se i kanë dërguar raportet tek donatorët , dhe 33 organizata nuk e kanë dëshmuar se ku i kanë publikuar.




7. Rreth posedimit të Rregullores së Punës nga 113 organizata 94 kanë pohuar se kanë Rregullore të Punës dhe 19 që nuk kanë.

### Arsyet pse organizatat nuk posedojnë Rregullore të Punës



7.1 Për arsyet se pse organizatat nuk posedojnë Rregullore të Punës, nga 19 organizata sa kanë deklaruar se nuk posedojnë rregullore, 5 prej tyre janë përgjigjur që janë në përpunim të rregullores, 4 organizata kanë deklaruar se punojnë sipas statutit, 1 organizatë sepse punojnë si vullnetarë dhe 4 nuk kanë dhënë arsye .

**7.2 Nëse organizata posedon Rregullore të Punës a e ka të specifikuar çështjen e ngacmimeve seksuale në vendin e punës?**



7.2 Sa i përket rregullores së punës se a e kanë të specifikuar çështjen e ngacmimeve seksuale në vendin e punës, nga 93 organizata që janë përgjigjur në këtë pyetje 76 organizata e kanë të specifikuar këtë çështje dhe 17 organizata nuk e kanë.

**Sa i përket deklaratave nëse organizatat punojnë sipas parimeve të mëposhtme:**

- Organizata vepron konform misionit të saj, dhe qëllimit jo për përfitim, duke respektuar diversitetin shoqëror, respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe parimet bazë të demokracisë.
- Organizata është e pa anshme politikisht dhe është e pavarur në fushëveprimin e saj
- Organizata është e përkushtuar që gjatë zhvillimit të aktiviteteve të tyre në drejtim të përmbushjes së misionit i kushton kujdes maksimal ruajtjes së ambientit dhe promovon përgjegjësinë ambientale tek të tjerët.
- Organizata anëtare e CiviKos respekton Ligjin e Punës të Republikës së Kosovës në marrëdhëniet e tyre me stafin e angazhuar në organizatë.

Të gjitha organizatat janë përgjigjur se parimet më lartë janë 100 % të aplikueshme në organizatat e tyre.